



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk.II.nr. 301/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “Botek” Sh.P.K., me NRB:810356081., me seli në Prishtinë, Rr.”Agim Ramadani” p.nr, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Armend Daskaj, avokat në Prishtinë Rr. “UÇK” Hy.68, nr.1, kundër debitorit Ministria e Mbrojtjes, me seli në Prishtinë, Kazerma Adem Jashari, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1041/22 të datës 20.11.2023, me datë **04.06.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Ministria e Mbrojtjes, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1041/22 të datës 20.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1041/22 të datës 20.11.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Ministria e Mbrojtjes i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.77/21 i datës 12.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku. Ndërsa, ka lënë në fuqi Urdhrin P.nr.77/21 i datës 12.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1041/22 të datës 20.11.2023.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë që të refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1041/22 të datës 20.11.2023 ta lë në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Botek” Sh.P.K., me dt. 12.04.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës Nr.220221/2 e datës 22.02.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur shumën prej 8,773.94 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të pagesës së faturës, dhe shpenzimet për përpilim të propozimit për përmbartim në shumë prej 104.00 euro.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, për faktin se bazuar në kontratën e lidhur në mes palëve afati kohor për dorëzim do të jetë 90 ditë nga momenti i marrjes së urdhërit të blerjes, jo më vonë se 15.12.2021, dhe sipas menaxherit të kontratës janë të paraqitura ditët e vonesës sipas liferimeve siç prezantohet në raportet e pranimit nga menaxheri i kontratës. Ka shtuar se debitori ka përmbushur obligimin financiar sipas kontratës ndërsa sa i përket pretendimit për borxhin e pa paguar, ju kujtojmë se për shumatat e pretenduara të kreditorit është bërë ndëshkimi për vonesat në përmbushje të kontratës nga ana e kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se pretendimet e debitorit se me mos pagesën e shumës prej 8,773.94 euro duke u bazuar në nenin 16 të kontratës e ka penalizuar kreditorin për shkak të vonesës së dërgesës së mallit të porositur, për të cilën vonesë kreditori e ka njoftuar debitorin se shkaqet e vonesës së dërgesës së mallit vijnë si pasojë e Corona Virusit Covid-19. Ka shtuar se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka nxjerr njoftim me të cilin ka obliguar të gjitha autoritet kontraktuese të mos i penalizojnë operatorët ekonomik ose të mos ndërmarrin masa tjera të përgjegjësisë kontraktuale në lidhje me operatorët ekonomik për vonesat me kryerjen e kontratave publike, nëse kontraktuesit vërtetojnë se ato vonesa janë për shkak të covid-19. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor, dhe të obligohet debitorit që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1041/22 të datës 20.11.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Ministria e Mbrojtjes i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.77/21 i datës 12.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku.

Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin P.nr.77/21 i datës 12.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Fatura me Nr.220221/2 e datës 22.02.2021, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkojnë me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohet si dokument i besueshëm. Po ashtu, fatura është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, fatura e lartcekur edhe pse nuk përmban vulën e pranimit e njëjta është nënshkruar nga personi i autorizuar dhe konsiderohet si pranimit i rregullt, pasi që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë, për më tej debitori ka bërë pagesën e pjesës së obligimit sipas faturës objekt i përmbartimit, andaj vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit të argumentoj me prova juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi

i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkalles së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.301/24 me datë 04.06.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**